

Drejtoria Rajonale e OSSH Fier

Data 23.11.2023

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: *Sherbim i ruajtjes dhe shoqerimit te vlerave monetare per Njesine e Koordinimit Fier & Vlore FSHU sh.a Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 33 muaj ose deri ne momentin kur shoqeria Ilyrian Guard sh.a ne zbatim te VKM nr.177, date 04.04.2019 do te garantoje ofrimin e shërbimit objekt i kesaj kontrate .*

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):, **79713000-5**,
Shërbime te Sigurimit (Roje).

VLERA E FONDIT LIMIT: 31,475.730(tridhjetë e një milion e katerqind e shtatedhjetë e pesë mijë e shtateqind e tridhjetë) leke **pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria Rajonale e OSSH Fier, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës nr. 3

b. *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës nr. 9*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

1. *Liçencë e shoqërisë për ushtrimin e aktivitetit në fushën e “Shërbimi privat të sigurisë fizike”, lëshuar në bazë të Ligjit nr. 75/2014, nënkategoria 1.3.B.*
2. *Certifikate e titullarit të subjektit, e vlefshme për ushtrimin e aktivitetit në fushën e veprimtarisë së shërbimit privat të sigurisë fizike, lëshuar në bazë të Ligjit nr. 75/2014 dhe Udhezimit të Ministrisë të Brendshme nr.130, datë 05.03.2018, nënkategoria 1.3.B.*
3. *Certifikate e drejtuesit teknik, e vlefshme për ushtrimin e aktivitetit në fushën e shërbimit privat të sigurisë fizike, lëshuar në bazë të Ligjit nr. 75/2014 dhe Udhezimit të Ministrisë të Brendshme nr.130, datë 05.03.2018, nënkategoria 1.3.B.*
4. *Çertifikata për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave në bazë të Ligjit nr. 75/2014 dhe Udhezimit të Ministrisë të Brendshme nr.130, datë 05.03.2018, nënkategoria 1.3.B, për të paktën 10 (dhjetë) punonjës shërbimi, nga të cilët 4 (kater) punonjës shërbimi të certifikuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier dhe 6 (gjashtë) të certifikuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Vlore.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në nenin 14/b të Ligjit nr. 75 /2014 Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike dhe në Kreun I të Udhezimit Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrisë të Brendshme.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Ky kriter shërben për të garantuar AK-në së OE ofertues janë operatorë të përshtatshëm dhe zotërojnë kapacitetet profesionale për të zbatuar kontratën.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për të provuar kapacitetin ekonomik dhe financiar operatori ekonomik të paraqesë :

- a. *Kopje të deklaratave të xhiros për të tre vitet e fundit (2020, 2021, 2022), ku vlera e xhiros në të paktën njërin prej tre viteve, të jete jo më e vogël se 100 % të fondit total limit të marrëveshjes kuader.*
- b. *Kopje të vërtetuar të bilanceve, të audituara nga ekspertet kontabël të licencuar, të konfirmuara nga autoritetet përkatëse të Administratës Tatimore, të tre viteve të fundit (2020, 2021, 2022) ku të paktën në dy bilancet e njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Akti Ekspertizë e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga Operatori Ekonomik vetëm në rastet kur janë në kushtet e përcaktuara*

nga neni 41, germa 'c' e ligjit nr. 10091, date 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" (i ndryshuar).

- c. *Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2022, pranë njësive vendore ku operatori ekonomik është regjistruar në QKB.*

Ky kriter përmbushet nepermjet paraqitjes nga Operatoret Ekonomik te Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 9 te DST-ve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/2009: "*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej **50 milionë lekësh**; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej **100 milionë lekësh**; iii) ka, mesatarisht, **30 të punësuar** gjatë periudhës kontabël".*

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Argumentimi: Në bazë të pikave 1 dhe 3, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", në Neni 5, Rregulla të përbashkëta për taksat vendore, dhe në KREU II, Taksat vendore, Neni 9, Llojet e taksave vendore, të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 Për Sistemin E Taksave Vendore, (i Ndryshuar).

Me anë të kriterit për të paraqitur dokumentacionin e shlyerjes së taksave vendore kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se ushtrijne aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.

2.3.1 Aftësitë teknike

1. Dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë **jo me te vogel se 12,590,292**, (sa 40 % të vlerës së fondit të Marreveshjes Kuader), të kryera gjatë tre viteve të fundit, llogaritur ky afat nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
 - i. Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
 - ii. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat si dëshmi pranohen vetëm faturat tatimore të shitjes, të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke pasur parasysh se shërbimi i ruajtjes dhe shoqërimit të vlerave monetare është një shërbim shumë i rëndësishëm, është parë e arsyeshme që operatori ekonomik duhet të ketë eksepriencë të mëparshme për të garantuar shërbimin e kërkuar dhe për të vërtetuar aftësitë e tij.

2.3.2. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **kapacitetet teknike dhe personelin kryesor**, si më poshtë:

2. *Operatori Ekonomik të ketë Qender Kontrolli në Qarkun Fier dhe në Qarkun Vlore, fakt i cili provohet me paraqitjen e Aktit të Miratimit të lëshuar nga Drejtorite Vendore të Policisë perkatese. Akti i Miratimit të Qendrës së Kontrollit, të jetë lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier dhe Drejtoria Vendore e Policisë Vlore, në bazë të nenit 22 të Ligjit nr. 75/2014 “Për shërbimin Privat të sigurisë fizike” dhe Udhezimit të Ministrisë të Brendshme nr.130, datë 05.03.2018 “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë”*
3. *Operatori ekonomik të paraqesë vërtetim nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier dhe Drejtoria Vendore e Policisë Vlore, lëshuar brenda 30 ditëve nga data e hapjes së ofertave, në të cilën pasqyrohet informacioni i mëposhtëm :*
 - a. *Për numrin e punonjësve të shërbimit të certifikuar për jo më pak se 10 (dhjetë) punonjës shërbimi, në kategorinë I.3.B, nga të cilët 4 (kater) nga qarkun Fier dhe 6 (gjashtë) në qarkun Vlore*
 - b. *Të ketë perkatesisht jo më pak se 5 (pese) operator për çdo qender kontrolli (Fier dhe Vlore).*
 - c. *Që ka jelek anti plumb, radiokomunikimi, hekura lidhës, shkopinj gome.*

- d. *Nuk ka masë administrative per operatorin ekonomik (Subjektin), Titullarin e Subjektit dhe Drejtuesin Teknik, sipas percaktimeve te kreut V, te Ligjit nr.75/2014, gjate viteve 2020, 2021, 2022, e ne vazhdim.*
- e. *Nuk ka ngjarje gjate viteve 2020, 2021, 2022 e ne vazhdim.*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe ligji 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Per Shërbimin e ruajtjes se vlerave monetare, te cilat kane nje rendesi te vecante.

- 4. *Autorizim individual, lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, për “Radiokomunikimin” konform Ligjit Nr.9918 datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, sipas te cilit operatori ekonomik te jete liçencuar për perdorim te frekuencave per radiokomunikim ne zonat ku ndodhen objektet ku do te kryhet shërbimi.*
- 5. *Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për tre muajt e fundit nga data e hapjes se ofertave, shoqëruar me listë pagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë të konfirmuara elektronikisht nga organet tatimore. Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht 12 punonjës të siguruar në muaj, 10 punonjes shërbimi si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin.*

Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes nga Operatoret Ekonomik te Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 9 te DST-ve.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 1, të Neni 65 Përdorimi i frekuencave, të Ligjit Nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ku parashikohet se: Personat fizikë apo juridikë mund të përdorin frekuenca vetëm pasi të jenë pajisur, paraprakisht, me autorizim nga AKEP-i, sipas përcaktimeve të këtij ligji.*

Ky kriter shërben për të garantuar AK-në së OE ofertues janë operatorë të përshtatshëm dhe zotërojnë kapacitetet teknike (pajisjet e shërbimit) për të zbatuar kontratën.

- 6. *Operatori ekonomik duhet të disponoje të paktën 5 (pese) mjete të blinduara ne pronesi me norme blindimi sipas Udhezimit te Ministrit te Brendshem nr.130, date 05.03.2018, minimalisht BR3. Pronësia e automjeteve te vertetohet duke paraqitur, Autorizim leshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Policise, lejen e qarkullimit te tyre, siguracion te vlefshem, akt kolaudimi te vlefshem dhe taksa.*

Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes nga Operatoret Ekonomik te Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 9 te DST-ve.

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojëfuqi punëtores prej **minimalisht 12 persona**, 10 punonjës shtetësi dhe drejtuesin teknik dhe administratorin.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

- a) *Gjithashtu OE duhet të paraqes Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për tre muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, shoqëruar me listë pagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë të konfirmuara nga organet tatimore. Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht **12** punonjës të siguruar në muaj, **10** punonjës shtetësi dhe drejtuesin teknik dhe administratorin.*

Ky kriter përmbushet nepermjet paraqitjes nga Operatoret Ekonomik të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 9 të DST-ve.

Ne rast se operatori shpallet fitues, përpara lidhjes së kontratës duhet të dorëzojë dokumentat provuese për vetëdeklarimet që ka bërë në formularin përmbledhës të vetë deklarimit (dokumentacioni i plotë ligjorë i mjeteve, neni 82, pika 5/b LPP)

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtores të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i punonjësve, 2 për çdo eskort, është përcaktuar në bazë të Udhezimit nr.130, datë 03.05.2018.

2.3.4. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën 5 (pese) mjete të blinduara në pronesi me norme blindimi sipas Udhezimit të Ministrit të Brendshëm nr.130, datë 05.03.2018, minimalisht BR3. Pronësia e automjeteve të vertetohet duke paraqitur, Autorizim leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, lejen e qarkullimit të tyre, siguracion të vlefshëm, akt kolaudimi të vlefshëm dhe taksa.

Ky kriter përmbushet nepermjet paraqitjes nga Operatoret Ekonomik të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 9 të DST-ve.

Ne rast se operatori shpallet fitues, përpara lidhjes së kontratës duhet të dorëzojë dokumentat provuese për vetëdeklarimet që ka bërë në formularin përmbledhës të vetë deklarimit (dokumentacioni i plotë ligjorë i mjeteve, neni 82, pika 5/b LPP)

7. **Operatori Ekonomik duhet të vertetojë se disponon në pronesi jo më pak se **10** (dhjetë) **arme zjarri krahu**. Për të vertetuar këtë duhet të paraqes:**

1. *Autorizim per blerje arme zjarri krahu, leshuar per subjektin e licencuar per nen-kategoria 1.3 B nga Drejtoria e Pergjithshme e Policise.*
2. *Kontrate shitblerje arme me nje shoqeri te licensuar per shitblerje armesh shoqeruar me numrin serial per secilen arme.*
3. *Faturat tatimore shoqeruar me mandat pagesat e bankes.*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicionmjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Ne baze te Ligjit nr.75/2014 “Per sherbimin e ruajtjes dhe sigurise fizike” dhe Udhhezimit nr.130, date 05.03.2018, transporti i vlerave monetare behet me mjete te blinduara, te autorizuar per kryerjen e ketij sherbimin me autorizim perkates nga Drejtoria e Pergjithshme e Policise se Shtetit. Numri 5 i mjeteve te blinduara eshte percakruar ne baze te numrit te KNK ku do te kryhet ky sherbim, te percaktuara ne shtojcen 7 te Dokumentave te Tenderit “Formulari i Termave te References”.

Kriteri per pronesine e armeve (te gjata) bazohet ne nenin 7 e vijues te Ligjit 74/2014 “Per armet” si dhe nenet 32, 33, 34, 35 te Ligjit 75/2014 “Per sherbimin privat te sigurise fizike”. Numri i armeve 10 te gjata eshte percaktuar numrit te rojeve 10, qe do te kryejne sherbimin te ndare ne 5 eskorta.

2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatorët ekonomikë duhet te paraqesin analizen e kostos per oferten e paraqitur (preventiv per nje roje ne muaj). Operatoret ekonomik duhet te percaktoje cmimin e ofertes duke respektuar aktet ligjore dhe nenligjore ne fuqi (si psh: page baze, shtesat mbi page turni II, sigurimet shoqerore...etj). Ofertat qe nuk respektojne kerkesat ligjore do te konsiderohen nenkoston ligjore dhe do te skualifikohen.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shtojca 5.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

- Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:
 - Grupi i shoqerimit të vlerave monetare të SHPRSF-se duhet të jete i perbere nga punonjes të certifikuar në Nenkategorinë 1.3.B sipas parashikimeve të Kreut VI pika C për shoqërimin e vlerave monetare. Keta punonjes duhet të jene të pajisur me mjete mbrojtese, uniforme dhe dokument identifikimi sic parashikohet në Ligjin Nr.75/2014 "Per Sherbimin Privat të Sigurise Fizike " dhe Udhezimin Nr. 130 datë 05.03.2018 të Ministrit të Brendshëm botuar në Fletoren Zyrtare date 09.03.2018 .
 - Ky Grup duhet të shoqeroje vlerat monetare që i janë besuar dhe të siguroje jeten e personelit gjatë transportit të vlerave monetare. Detyra e tij funksionale është Shoqerimi i sigurte i punonjesve (arketareve) nga Filialet e FSHU sh.a drejt filialeve të Bankave respektive sipas zgjedhjes së FSHU sh.a.
 - Punonjesi i FSHU sh.a (arketari/ja) duhet të shoqerohet nga 2 (dy) punonjes shërbimi të armatosur.
 - Për transportin e vlerave monetare Ofertuesi duhet të pajisë punonjesit e shërbimit me arme sipas përcaktimeve ligjore të Ligjit Nr.75 /2014 "Per Sherbimin Privat të Sigurise Fizike ".
 - Shoqerimi duhet të kryhet nga një mjet i Operatorit Ekonomik. Mjeti duhet të jete i blinduar, i loguar në gjendje të rregullt teknike dhe dokumentare që të kryejë shoqërimin e vlerave monetare. Automjetet që transportojnë vlera monetare ndalohet që të vendosin në to dhe të përdorin pajisje zanore alarmi apo sisteme pamore me dritë vezulluese.
 - Shoqerimi i vlerave monetare do të kryhet një ose dy here në ditë sipas grafikut të ekzekutimit të përcaktuar dhe në zbatim të plote të instruksioneve të personave përgjegjës të FSHU sh.a, me grafik shërbimi përkatesisht nga dita e hënë - shtunë.
 - Koha maksimale e procesit të shoqërimin të vlerave monetare do të jetë 2(dy) ore.
-
- Ofruesi i Shërbimit duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme :
 - Te jete i certifikuar nga autoritetet kompetente për ushtrimin e funksionit.
 - Te reflektoje një sjellje korrekte dhe të respektueshme.
 - Gjatë gjithë kohës së shërbimit punonjesi i Shoqërisë SHPRSF duhet të respektojë rregullat e brendshme të FSHU sh.a.

- Të kërkojë nga punonjësit të zbatojnë rregullat e brendshme të Objektivit.
- Punonjësi i Shërbimit duhet të jetë i aftë të reagojë dhe të vepronte gjithmonë në përputhje me instruksionet e personave përgjegjës të përcaktuar nga FSHU sh.a.
- Punonjësit e Shoqërisë SHPRSF që kryejnë shoqërimin e vlerave monetare duhet të jenë të pajisur me armatim sipas ligjeve në fuqi dhe në zbatim të Udhezimit të Ministrisë të Brendshme Nr.130 datë 05.03.2018 “Për Funkcionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike” si dhe me mjete speciale për përballimin e situatave nga sulme të mundshme me qëllim grabitjen e vlerave monetare (Radio, Shkop gome, hekurë lidhës,... etj).
- Shoqëria private për të siguruar shoqërimin e vlerave monetare dhe për realizimin me korrektesë të detyrës duhet të vete në dispozicion të punonjësve armatim dhe pajisje të shërbimit; armatim personal sipas ligjit për armet, jelek antiplumb, hekurë lidhës, shkop gome, radio nderlidhje dhe GPS.
- Të gjithë punonjësit e shërbimit sipas Udhezimit nr.130, datë 05.03.2018 “Për Funkcionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike”, duhet të mbajnë dokumentin e identifikimit në vend të dukshëm dhe vetëm gjatë kryerjes së detyrës ata detyrohen të paraqesin atë sa herë u kërkohet për identifikim nga strukturat e policisë apo organet e tjera ligjzbatuese.
- Të gjithë punonjësit e ofruesit të shërbimit të kërkuar duhet të jenë të pajisur me uniformën operacionale me elementet përberës dhe të gjitha materialet e nevojshme logjistike sipas Ligjit Nr.75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike” të publikuar në Fletoren Zyrtare datë 08.08.2014 dhe Udhezimit Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrisë të Brendshme “Për Funkcionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike”, publikuar në Fletoren Zyrtare datë 09.03.2018.
- Në zbatim të Nenit 27 pika c e Ligjit Nr.75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike”, punonjësi i shërbimit ka përgjegjësi të mbaje sipas rregullores armatimin personal dhe pajisjet e shërbimit, të perdore uniformën, shenjat dhe simbolet e SHPRSF-së vetëm gjatë kryerjes së detyrës si dhe të perdore armet sipas legjislatcionit në fuqi.
- Në lidhje me përdorimin e forcës, punonjësit e shërbimit duhet të zbatojnë Nenin 33 të Ligjit Nr.75/14 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike” ku përcaktohet qartë se: “Punonjësi i Shërbimit i SHPSF-së përdor forcën fizike dhe pajisjet e mjetet e tjera, të dhëna për përmbushjen e detyrës, vetëm kur kjo është e nevojshme dhe nëse masat e tjera nuk kanë dhënë rezultat, në përputhje me kriteret e përshkallëzimit të saj. Punonjësi i shërbimit përshkallëzon nivelin e nevojshëm të përdorimit të forcës, duke filluar nga bindja me fjalë, shtrëngimi fizik, deri të shkopi i gomës. Punonjësi i shërbimit duhet të paralajmërojë se do të përdorë forcën para përdorimit të saj”.
- Drejtuesi Teknik i SHPSF-së është drejtuesi më i lartë teknik i shoqërisë dhe do të përgjigjet për organizimin, drejtimin, kontrollin e kryerjes së shërbimit për shoqërimin dhe sigurimin e vlerave monetare gjatë transportit. Ai duhet të përcaktojë rregullat e funksionimit të SHPSF-së në lidhje me ruajtjen e objektit, personit apo shoqërimin e vlerave monetare në lëvizje, si dhe të përpilojë planifikimin për çdo objekt së bashku me skemat e ruajtjes dhe plane të veçanta ruajtje për situata emergjente. Ai do të jetë përgjegjës për informimin në kohë të strukturave të Policisë së Shtetit, si dhe do të sigurojë bashkëpunimin e vazhdueshëm me to për probleme që lidhen me sigurinë e objektit në ruajtje; Drejtuesi Teknik planifikon shërbimet për shoqërimin e vlerave monetare në lëvizje.

- Serveri bazë të jetë i pajisur me qendrën multifunksionale ku të ketë sistemin bazë të marrjes, përpunimit dhe ruajtjes së sinjaleve të alarmit, të marrjes dhe administrimit të të dhënave, në të gjitha rrugët e sigurimit, radio, GPS-GPRS, GPRS, ADSL.
- Qendra e Kontrollit duhet të realizojë monitorimin me anë të sistemit të kamerave të cilësisë së lartë, gjurmimin dhe lokalizimi në kohë reale të automjeteve nëpërmjet sistemit GPS/GPRS, si dhe :
 - nëpërmjet telefonit celular (GSM);
 - nëpërmjet telefonit fiks (Contact ID);
 - (radio).

Shtojca 6

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: “ *Sherbim i ruajtjes dhe shoqerimit te vlerave monetare per Njesine e Koordinimit Fier dhe Vlore FSHU sh.a Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 33 muaj* ”

Afatet e ekzekutimit: 33 (tridhjete etre)muaj

Grafiku i ekzekutimit te sherbimit sipas tabelës bashkangjitur sipas zonave perkatese:

Numri i KNK/arkave	Turnet	Numri i punonjesve te sherbimit per 1 eskort	Afati i levrimit
10	I	2	33 muaj <i>Kontratat do te jepen nga momenti i lidhjes se Marrveshjes Kuader me OE shpallur fitues nga kjo procedure prokurimi, sipas përcaktimit të AK me afat perfundimtar 33 muaj</i>

6	II	2	33 muaj <i>Kontratat do te jepen nga momenti i lidhjes se Marrveshjes Kuader me OE shpallur fitues nga kjo procedure prokurimi, sipas përcaktimit të AK me afat perfundimtar 33 muaj</i>
----------	-----------	----------	----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Sherbimi do te kryhet nga dita e Hene deri ditën e Shtune. Koha maksimale e procesit te shoqerimit te vlerave monetare per te dyja Turnet do te jetë 2 (dy) ore.

Koha e kryerjes se sherbimit te shoqerimit të vlerave monetare dhe destinacionet do të jenë si meposhte:

Vendndodhja	Orari i Turneve	Drejtimi i levizjes
Rajoni Fier		
KNK 1 Fier	Turni I : 14.00 – 16.00	KNK 1 Fier – Bank Fier
	Turni II: 20.00 – 22.00	KNK 1 Fier – Bank Fier
KNK 2 Fier	Turni I : 14.00 – 16.00	KNK 2 Fier – Bank Fier
	Turni II: 20.00 – 22.00	KNK 2 Fier – Bank Fier
KNK Patos	Turni I : 15.00 – 17.00	KNK Patos – Bank Patos
KNK Roskovec	Turni I : 15.00 – 17.00	KNK Roskovec – Bank Roskovec
KNK Ballsh	Turni I : 15.00 – 17.00	KNK Ballsh – Bank Ballsh

Rajoni Vlore

KNK 1 “Conad” Vlore	Turni I : 14.00 – 16.00	KNK 1 “Conad” – Bank Vlore
	Turni II: 20.00 – 22.00	KNK 1 Conad” – Bank Vlore
KNK 2 “Skele” Vlore	Turni I : 14.00 – 16.00	KNK 2 “Skele” – Bank Vlore
	Turni II: 20.00 – 22.00	KNK 2 “Skele” – Bank Vlore
KNK 3 “Kastrati” Vlore	Turni I : 14.00 – 16.00	KNK 3 “Kastrati” – Bank Vlore
	Turni II: 20.00 – 22.00	
KNK Orikum	Turni I : 14.00 – 16.00	KNK Orikum – Bank Orikum
KNK Himare	Turni I : 14.00 – 16.00	KNK Himare – Bank Himare
	Turni II: 20.00 – 22.00	KNK Himare – Bank Himare

Shtojca 7

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

“Sherbim i ruajtjes dhe shoqerimit te vlerave monetare per Njesine e Koordinimit Fier dhe Vlore FSHU sh.a Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 36 muaj

Kontratat do të lidhen sipas afateve të përcaktuara nga AK.

- **Shoqerimi i sigurte i punonjesve (arketareve) nga filialet e FSHU sh.a drejt filialeve te bankave respektive sipas zgjedhjes së FSHU sh.a.**
- **Punonjësi i FSHU sh.a (arketari/rja) duhet te shoqerohet nga 2 (dy) punonjes sherbimi të armatosur, njeri prej te cileve shoferi i mjetit te blinduar.**
- **Punonjesit e sherbimit duhet te jene trajnuar dhe certifikuar per perdorimin e armes dhe gjate kryerjes se sherbimit te pajisur me armatim sipas ligjeve në fuqi.**
- **Shoqërimi duhet te kryhet nga një mjet i kompanisë së shoqerimit, mjete duhet te jete i blinduar, loguar, ne gjendje te rregullt teknike dhe dokumentare te kryeje shoqerimin e vlerave monetare. Automjeti i blinduar duhet te jete i pajisur me autorizimin vjetor te Drejtorit te Pergjithshem te Policise se Shtetit ku te jene percaktuar niveli i blindimit, GPS, sistem vezhgimi, radio komunikimi etj; kerkesa keto te detyrueshme per cdo automjet te blinduar. Automjetet që transportojnë vlera monetare ndaloheq të vendosin në to dhe te përdorin pajisje zanore alarmi apo sisteme pamore me dritë vezulluese.**
- **Ekskortat qe transportojne vlera monetare nuk duhet te ndalojne ne asnje rast gjate levizjes me ngarkese per transportin e vlerave monetare.**
- **Kohezgjatja e Sherbimit perfshine :**
 1. **paraqitjen e Grupeve te Shoqerimit ne orarin e percaktuar,**

2. shoqerimi i arketaeve nga **KNK** deri ne mjetin e blinduar,
 3. transporti i vlerave monetare nga **KNK/Arka** me destinacion Deget e Bankes se nivelit te dyte,
 4. shoqerimi i arketereve nga mjete i blinduar ne degen e Bankes se nivelit te dyte dhe deri ne perfundimin e procesit te depozitimit te vlerave monetare nga arketaet ne Bank.
- Të gjithë punonjësit e ofruesit të shërbimit të kërkuar duhet të jenë të pajisur me uniformen dhe të gjitha materialet e nevojshme llogjistike sipas ligjit nr.75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” të publikuar ne fletoren zyrtare date 08.08.2014, Udhezimi i Ministrit te Brendshem nr.130, date 05.03.2018, dhe në aktet e tjera nënligjore.

Shpërndarja: Shërbimi i shoqerimit te vlerave monetare do te kryhet me eskortat, ne KNK dhe ne Turnet sipas Tabeles se meposhteme :

Vendndodhja	Turni I	Turni II
Rajoni Fier		
KNK 1 Fier	T1	T2
KNK 2 Fier	T1	T2
KNK Patos	T1	JO
KNK Roskovec	T1	JO
KNK Ballsh	T1	JO
Rajoni Vlore		
KNK 1 “Conad” Vlore	T1	T2

KNK 2 “Skele” Vlore	T1	T2
KNK 3 “Kastrati” Vlore	T1	T2
KNK Orikum	T1	JO
KNK Himare	T1	T2

Vendi dhe dorezimi i shërbimeve: Sipas tabelës së mësipërme.

NJESIA E PROKURIMIT